

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit
“MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”
të ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Rovena Bahiti

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Korrik/2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Fakulteti /Departamenti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike /Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor
3	VKA/Urdhëri i licencimit	VKA Nr. 171, datë 07.07.2016 UMAS Nr. 408, datë 27.07.2016
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional” në “Sistemet e Informacionit në Biznes”
5	Cikli i studimit:	Ciki II
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/)	Me kohe të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin)/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
13	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
14	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
15	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2016-2017
16	Numri i studenteve	2016-2017 1 student 2017-2018 15 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

SHKURTIME

AL	Arsimi i Lartë
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimit e Lartë
FSHE	Fakulteti i Shkencave Ekonomike
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
LALKSH	Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor
MAS	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MP	Master Profesional
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
NJSBCZHK	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës
PA	Personel Administrativ
PAE	Personel Akademik Efektiv
PAK	Personel Akademik me Kontratë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
RSH	Republika e Shqipërisë
SSHC	Standardet Shtetërore të Cilësisë
SIB	“Sistemet e Informacioni në Biznes”
UMSH	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore
ZEAL	Zona Europiane e Arsimit të Lartë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”

(Të dhëna zyrtare për hapjen e programit të studimit, miratimin e hapjes etj).

Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes”, është hapur në bazë të Urdhërit të MAS Nr. 408, datë 27.07.2016 mbështetur në Vendimin nr. 171, datë 07.07.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Struktura akademike përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” është Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, me përgjegjës Dr. Dolantina Hyka, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, nën drejtimin e Dekan Prof. Asoc. Dr. Alqi Naqellari në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë”.

Studimet master në këtë program zgjasin 1(një) vit akademik /2 (dy) semestra, në gjuhën shqipe. Forma e studimit është studime me kohë të plotë dhe studentët për tu diplomuar duhet të realizojnë 60 ECTS (kredite). Në përfundim të programit të studimit studentët pajisen me diplomë: “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes”.

Në këtë program studimi janë të rregjistruar për herë të parë dhe ndjekin studimet aktualisht 15 studentë gjatë vitit akademik 2017 – 2018.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Rovena Bahiti
2. Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Gjatë zhvillimit të procedurës, GVJ, është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Renata Qatipi.

Më datë 26.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 87/23, datë 26.06.2018 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, UMSH është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 03.07.2018, UMSH përcjell nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL dhe zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me Nr. 301/10 Prot., datë 03.07.2018, “Kthim përgjigje Tuajës me Nr. 87/23, datë 26.06.2018 për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Sistemet e Informacionit në Biznes””. Në këtë dokument institucioni nuk ka sjellë komente, dhe shprehet se është dakort me RVJ.

Draft Raporti bëhet Raport përfundimtar i vlerësimit.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është themeluar në vitin 2007 dhe me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 i është dhënë leja për hapjen e institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë". Si e tillë është akredituar institucionalisht me urdhër të MASH nr. 124, datë 29.03.2012, sipas rekomandimit të vendimit të KA nr. 303, datë 13.01.2012. Gjithashtu ky institucion ka kryer procesin e vlerësimit periodik në kuadër të akreditimit institucional.

Ky institucion ka pësuar disa riorganizime gjatë aktivitetit të tij. Riorganizime të cilat janë finalizur me marrjen e statusit Universitet. Me Urdhër 278, datë 19.05.2017 të MAS është miratuar statuti i Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë". Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Mardhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike të cilat organizojnë: Studime të Ciklit të Parë "Bachelor" dhe të Ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional".

Struktura akademike përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit "Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes" është Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, të Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë". Misioni i këtij programi studimi është të zhvillojë njohuritë thelbësore të informatikës së biznesit që lidhen kryesisht me dizejnimin dhe zbatimin e sistemeve të reja informatike që ndërthuren me teknologjinë e informacionit, biznesin, dhe ekonominë. Objektivi kryesor i programit të studimit "MP në Sistemet e Informacionit në Biznes" është pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqiptar. Ky program synon të garantojë njëkohësisht:

- Sigurimin e informimit dhe kërkimit të vazhdueshëm në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ekonomisë.
- Krijimin dhe përhapjen e ideve të reja dhe të dobishme për shoqërinë në tërësi dhe komunitetin akademik në veçanti.
- Ideimin, ndërtimin dhe vendosjen në praktikë të sistemeve dhe programeve sipas trendeve më të fundit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.
- Aplikimin e software-ve të ndryshëm në fushën e aktuaristikës dhe pjesë të tjera të punës së sigurimeve shëndetësore e shoqërore, në fushën financiare , atë të drejtimit etj.

Në këtë mënyrë, ky program siguron përgatitjen e një brezi të ri programuesish, analistësh dhe manaxhuesish projektsh të cilët janë të gatshëm të përthithen direkt nga tregu i punës në Shqipëri e më gjerë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Në bazë të statutit të UMSH, misioni i Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë" është ofrimi i arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese si dhe formimi i
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;

Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

studiuesve të rinj në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik. Qëllimi i UMSH është të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme, të bazuara në kërkim dhe njohuri shkencore, për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj. Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” është vazhdimi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi dhe synon pasurimin e dijeve të studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në Sistemet e Informacionit në Biznes, duke mbështetur kështu misionin dhe qëllimin e përgjithshëm të këtij institucioni.

Gjatë vizitës në institucion dhe sipas RVB u pohua se ky program është hartuar pasi janë analizuar kërkesat e tregut të punës nëpërmjet:

- Vëzhgimit që Qendra “Mesdheu” ka realizuar ndaj të gjithë portaleve të punësimit.
- Analizës së Zyrës së Karrierës në portalet e zyrave të punësimit.
- Takimeve që Qendra "Mesdheu" ka zhvilluar me subjekte të ndryshme të biznesit.

Në bazë të vëzhgimeve të hollësishme të zhvillimit të tregut të punës, Qendra “Mesdheu” ka arritur në konkluzionin se profesioni i specialistit të lartë të Sistemeve të Informacionit në Biznes është ndër tre profesionet më të kërkuara në treg. Për këtë arsye ky program, siguron përgatitjen e një brezi të ri programuesish, analistësh dhe menaxherësh projektësh, të cilët janë të gatshëm të përthithen nga tregu i punës në Shqipëri e më gjerë.

Hartimi i programit të studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit duke u mbështetur në shqyrtimin dhe krahasimin e kërkesave të tregut të punës dhe ofertës respektive për specialistë të kësaj fushe në bazë të vëzhgimeve të qendrës “Mesdheu” dhe jo vetëm. Rekomandimet e saj pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe kurrikulën e programit të studimit duke mundësuar që ky program të jetë në përputhje të plotë me politikat ekonomike të zhvillimit të vendit, me nevojat aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe me kërkesën e ndryshimit cilësor të nivelit të investimeve. Në këtë aspekt, ky program evidenton, menaxhon dhe zhvillon aplikimin e njohurive të reja në vendimmarrjet inovative ekonomike.

Programi i studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” nuk përmban ndonjë lëndë

	që të evidentojë në mënyrë eksplicite ruajtjen e vlerave kulturore të kombit por as që ti dëmtojë ato.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	<p>Bazuar tek dokumentat që pasqyrojnë “Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Programi “MP në Sisteme Informacioni në Biznes”” si dhe “Statutin e UMSH” mund të themi që programi i studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” është në përputhje me objektivat strategjike të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”, pasi është konceptuar në përputhje me misionin dhe Strategjinë për Zhvillim (2017-2021) të UMSH.</p> <p>Vetë strategjia e programit të studimit është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe jo vetëm, dhe ka si qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe përvetësimin e dijeve në nivel cilësor duke synuar që UMSH të zërë një vend elitare në arsimin e lartë në Shqipëri. Kjo strategji gjithashtu pasqyron vizionin e UMSH për politikën afatmesme dhe afatgjatë në mësimdhënie dhe përvetësim dijesh.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore të Cilësisë, Karta e Bolonjës, ZEAL (Zona Europiane e Arsimit të Lartë) nga Udhëzimet e MASH/MAS dhe të ASCAL. Ky program është hapur me urdhër të Ministrit të MAS, Nr. 408, datë 27.07.2016 në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 35 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky urdhër u bazua tek vendimi nr. 171, datë 07.07.2016 i Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është i njëjtë me emërtimet e sistemit universitar italian dhe shqiptar, i reformuar mbi bazën e parimeve të Deklaratës së Bolonjës. Programi i studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të</p>	<p>Bazuar tek dokumenti që pasqyron “Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Programi “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” pika 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5 mund të themi që ky program studimi ka një plan strategjik në nivel</p>

<p>mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>institucional për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. Kjo strategji është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 6/20, si dhe në Strategjinë për Zhvillim (2017-2021) të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”.</p> <p>Sipas kësaj strategjie në të gjitha programet e studimit mbetet funksioni qendror rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky qëllim do të arrihet duke vlerësuar risitë në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog në lidhje me to në shkallë universiteti, por edhe në nivel kombëtar. Një vend të veçantë në këtë drejtim do të zërë trajnimi i pedagogëve dhe sidomos i atyre të rinj që do të bëhet pjesërisht me fondet e universitetit dhe pjesërisht me fondet e vetë pedagogëve. Në të gjitha programet cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies është një proces i matshëm, i krahasueshëm dhe që synon të përmirësohet vazhdimisht. Për këtë janë gjeneruar dhe raporte të vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga NJSBCZHK.</p>
---------------------------------------	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë” është hartuar brenda kuadrit të misionit dhe qëllimit të përgjithshëm të institucionit, i konceptuar si një vazhdim i ciklit të parë të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, që synon pasurimin e dijeve të studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në Sistemet e Informacionit në Biznes. Hartimi i programit është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit duke u mbështetur në shqyrtimin dhe krahasimin e kërkesave të tregut të punës dhe ofertës respektive për specialistë të kësaj fushe në bazë të vëzhgimeve të qendrës “Mesdheu” dhe jo vetëm.
2. Programi i studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” është në përputhje me objektivat strategjike të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”, pasi është konceptuar në përputhje me misionin dhe Strategjinë për Zhvillim (2017-2021) të UMSH.
3. Sipas urdhërit të MAS Nr. 408, datë 27.07.2016 bazuar tek vendimi nr. 171, datë 07.07.2016 i Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë u bë hapja e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” që është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
4. Përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit institucioni e mbështet tek “Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shencave Ekonomike, Programi “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” si dhe tek “Statuti i UMSH”.

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe personel akademikët e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka në përbërjen e tij 3 departamente:

- Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor (DIFSH)
- Departamenti i Ekonomisë (DEK)
- Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitetit (DFBK)

Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor ndahet në dy Grupe Mësimore Lëndore:

- Grupi i Informatikës
- Grupi i Matematikës dhe Statistikës

Personeli mësimdhënës ndahet në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK). Drejtuesit e njësive bazë dhe Dekanatit janë Personel Akademik Efektiv dhe punojnë me kohë të plotë në institucion. Personeli akademik i Departamentit së Informatikës dhe Formimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative, duke qenë përgjegjës për realizimin e programit të studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes”.

Struktura akademike përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes” në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë” është Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, me përgjegjës Dr. Dolantina Hyka, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, nën drejtimin e Dekan Prof. Asoc. Dr. Alqi Naqellari.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Ekonomike (organigrama) ndodhet në Grafikon 1 të Aneksit të RVJ.

- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabela 1 në Aneks të RVJ)

Tabela 1 në Aneks paraqet numrin e personelit akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) si dhe personelin administrativ mbështetës (PA) për çdo njësi të Fakultetit të Shkencave Ekonomike.

Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) Tabela 1 ka mospërputhje të shifrave totale me ato që pasqyrohen në kolonat përkatëse të numrit të personelit për çdo njësi bazë. Gjithashtu në këtë tabelë ka mospërputhje të numrit të deklaruar të PAE, PAK, me tituj dhe grada ose jo me Tabelën 2 që paraqet në mënyrë të detajuar emrat e personelit për çdo njësi të Fakultetit të Shkencave Ekonomike të cilat janë korrigjuar nga RVJ.

Pavarësisht kësaj këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

- Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, titujt/gradat, (Tabela 2 në Aneks të RVJ)

Tabela 2 në Aneks paraqet emrat dhe titujt/gradat e personelit akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) për çdo njësi të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, përgjegjës për programin e studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes”.

Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, UMSH i cili është përgjegjës për realizimin e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” ka në përbërjen e tij si personel akademik efektiv dhe me kontratë (PAE dhe PAK) si dhe personel akademik administrativ (PA):

- 14 anëtarë PAE nga të cilët:
 - 1 Akademik, Profesor Doktor
 - 3 Profesor Doktor (njëri prej të cilëve i ftuar nga Universite’ de Technologie de Compiegne, Francë)
 - 1 Doktor
 - 4 Msc në proces Doktorature
 - 5 Msc
- 6 anëtarë PAK nga të cilët:
 - 4 Profesor Doktor
 - 2 Doktor
- 13 anëtarë PA

Këshilli Shkencor i Programit të studimit/Koordinatori/ët e programit të studimit (Tabelën 3 në Aneks të RVJ)

Tabela 3 në Aneks paraqet emrat, titujt/gradat dhe pozicionin e anëtarëve në Këshillin Shkencor të programit të studimit “Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes”.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Në mbështetje të misionit të tij të shprehur në Nenin 4 të Statutit të UMSH, ky institucion është i organizuar në mënyrë të tillë që nëpërmjet fakulteteve të tij të ofrojë arsimin e lartë dhe veprimtaritë krijuese në fushat e shkencave ekonomike, juridike, mardhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike, që realizojnë synimet e tyre sociale brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë.</p> <p>Institucioni ka 3 (tre) fakultete, të cilat janë njësitë organizative kryesore të UMSH ku bashkërendohen mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, të cilat janë: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Mardhënieve Ndërkombëtare dhe, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.</p> <p>Secili fakultet organizohet në njësi bazë që janë departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe zhvillimit. Secili fakultet ka nga 3 (tre) departamente të cilat parqiten në organigramën e UMSH (Grafiku 1 në Aneks</p>

	<p>të RVJ).</p> <p>Çdo njësi bazë e Fakultetit, që është departamenti, ka misionin dhe objektiva të përcaktuara në mbështetje të misionit dhe objektivave të institucionit. Në të treja njësitë bazë, misioni dhe objektivat përkatëse janë vënë në shërbim të programeve të studimit, mbarëvajtjes dhe ndjekjes hap pas hapi të tyre.</p> <p>Këto pasqyrohen dhe në misionin dhe objektivat e programeve përkatëse (Aneks 3/3 i RVB). Departamenti si njësi bazë, përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplina mësimore respektive. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, zhvillimin e programeve të studimit në të dy ciklet, veprimtaritë kërkimore dhe shkencore, duke respektuar liritë akademike të personelit.</p> <p>Në bazë të Tabelës 1 (Aneks i RVJ) ku paraqitet numri i personelit akademik me tituj/grada ose jo, për çdo njësi të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, departamentet kanë më shumë se 7 anëtarë efektivë dhe më shumë se 3 me gradën shkencore Doktor në përbërjen e tyre.</p>
<p>eStandardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” e ka organizuar punën në dy grupe mësimore lëndore, të cilat janë Grupi i Informatikës dhe Grupi i Matematikës dhe Statistikës. Në secilin prej këtyre grupeve kemi një shpërndarje të drejtë të personelit akademik (PAE dhe PAK) me tituj/grada që bëjnë të mundur realizimin me sukses të këtij programi. (Aneks 4/3 i RVB). Anëtarët e njësisë bazë hartojnë syllabuset në përputhje me planin mësimor dhe vizionin për programin përkatës të studimit. Syllabuset shqyrtohen në grup-lëndët përkatëse dhe miratohen më vendim nga përgjegjësi i njësisë.</p> <p>Detyrat e njësisë bazë dhe kryesore janë të përcaktuara në rregulloren Institucionale Kreu IV Neni 13,18,19,20. Njësi bazë harton misionin, objektivat e programit të studimit, në përputhje me misionin dhe objektivat e saj. Harton planin mësimor dhe ia kalon për miratim dekanit.</p> <p>Në takimin me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Përgjegjësen e Departamentit të Informatikës dhe të Formimit Shkencor, si edhe me personelin akademik na u pohua se drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij, gjë që përcaktohet edhe në Statutin e UMSH, Rregulloren e UMSH, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Rregulloren e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1. UMSH është i organizuar në mënyrë të tillë që nëpërmjet 3 (tre) fakulteteve të tij të ofrojë arsimin e lartë dhe veprimtaritë krijuese në fushat e shkencave ekonomike, juridike, mardhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike në mbështetje të misionit të tij. Secili fakultet përbëhet nga 3 (tre) departamente të cilat kanë më shumë se 7 anëtarë efektivë dhe më shumë se 3 me gradën shkencore Doktor në përbërjen e tyre (pavarësisht nga disa gabime në Tabelën 1 të RVB që paraqet numrin e PAE, PAK dhe PA, ato nuk ndikojnë në plotësimin e standardit të mësipërm).**
- 2. Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” e ka organizuar punën në dy grupe mësimore lëndore, të cilat janë Grupi i Informatikës dhe Grupi i Matematikës dhe Statistikës. Anëtarët e njësisë bazë janë të angazhuar drejtpërdrejt në hartimin e syllabuseve dhe realizimin e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”.**

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Programi i studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” ka filluar vitin e parë të funksionimit në vitin akademik 2017-2018.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, për vitin akademik 2017-2018 kemi këto raporte:

- 2.14 (15/7) studentë të programit në total për çdo pedagog efektiv (të angazhuar në këtë program studimi);
- 1.87 (15/8) studentë të programit në total për çdo pedagog në total (të angazhuar në këtë program studimi);
- 15 (15/1) studentë të programit në total për çdo pedagog me kontratë (të angazhuar në këtë program studimi);

Politikat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në statutin e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”. Kërkesat për personel akademik të ri bëhen nga Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor në bazë të rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Statutit të UMSH.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 4 në Aneks)

Tabela 4 në Aneks paraqet të dhënat sipas kualifikimit për personelin akademik të programit të studimit "MP në Sistemet e Informacionit në Biznes".

Në programin e studimit janë të angazhuar 8 punonjës, nga të cilët 7 janë punonjës PAE (1 Akademik, 1 Prof. Ass., 2 Doktor dhe 3 Doktorantë në proces) dhe 1 punonjës PAK (1 Doktor). Formimi i personelit akademik është i duhuri për realizimin me sukses të programit të studimit.

Të dhëna për Raportet PAE/PAK sipas kualifikimit (Tabela 5 në Aneks)

Tabela 5 në Aneks paraqet të dhëna për Raportet PAE/PAK sipas kualifikimit, të programit të studimit "Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes".

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 6 në Aneks)

Tabela 6/1 në Aneks paraqet të dhëna sipas moshës për PAE. Tabela 6/2 në Aneks paraqet të dhëna sipas moshës për PAK të programit të studimit "Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes".

Nga punonjësit PAE Profesori është i moshës 66-68 (nga CV-të), Profesori i Asociuar është i moshës 56-65, Doktorit është i moshës 46-55 dhe 3 Doktorantet në proces janë të moshës 25-35. 5 janë femra, nga të cilat 3 me grada dhe 2 meshkuj, nga të cilët 1 me grada.

Nga Punonjësit PAK është një Doktor i moshës 25-35 (femër).

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 3 në Aneks)

Tabela 3 në Aneks paraqet emrat, titujt/gradat dhe pozicionin e anëtarëve në Këshillin Shkencor të programit të studimit "Master Profesional në Sistemet e Informacionit në Biznes".

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion disa kontrata pune të personelit akademik aktual të Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, të cilat ishin të hartuara në përputhje me Statutin dhe Rregulloren Organizative të UMSH, si dhe me Kodin e Punës të RSH. Në kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhënien juridike të punës, e mbështetur tek aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fillimi i punës konsiderohet data e nënshkrimit të kontratës së punës me Rektorin e UMSH. Punonjësit akademik merren në punë me kontrata me afate të pacaktuara ose të caktuara. Kontrata e punës përmban identitetin e palëve, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, kohëzgjatjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara, afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, elementet përbërëse të pagës, kohën normale javore të punës. Kontrata shoqërohet me anekse përkatëse për ngarkesën mësimore, punën shkencore, dokumentacionin etj. Kontrata është e hartuar në shqip dhe në anglisht.

Cilësia e personelit ndihmës akademik/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga RVB informohemi se numri i personelit administrativ në mbështetje edhe të këtij program studimi është 13 (përfshirë laborantet, sekretaret mësimore, punonjësit e bibliotekës, arkiva, shërbimi i informacionit etj.), por sic u informuam nga takimet, një pjesë e personelit akademik përveç veprimtarisë mësimore dhe asaj shkencore është angazhuar edhe në çështje administrative me qëllim manaxhimin e departamentit, programeve të studimit dhe nënfushave të departamentit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësuesor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësuesor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësuesor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Në mbështetje të objektivave të programit të studimit MP në SIB që synojnë të pajisin studentët me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqiptar, personeli akademik është angazhuar plotësisht. Këtë angazhim e shohim në pjesëmarrjen e tij në hartimin e kurrikulës së programit duke u mbështetur tek ajo e programit Bachelor të UMSH, programeve të ngjashme në institucione të tjera, konsultimet me ekspertët e fushës, nevojat e tregut të punës dhe institucioneve publike, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion vumë re se personeli administrativ i Teknologjisë së Informacionit (2 laborantë) siguronte mbarëvajtjen teknike të pajisjeve të teknologjisë në sallat e leksioneve, seminare, punës shkencore apo aktiviteteve të tjera dhe garantonte shërbimin e pandërprerë të internetit përmes sistemit WIFI. Sektori mbështetës dhe biblioteka siguronte bazën materiale dhe logjistike për mbarëvajtjen e punës mësimore, kërkimit shkencor dhe aktivitetit të përditshëm administrativ për pedagogët dhe studentët e këtij programi. Sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit, faja online ishin në shërbim të realizimit të objektivave të këtij programi studimi.</p> <p>Objektivat e mësipërme janë hartuar në mbështetje të “Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Programi MP në SIB” si dhe “Strategjisë së UMSH” duke mundësuar që personeli akademik dhe administrativ i institucionit të angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga vizita në institucion në takimin me personelin akademik na u pohua se personeli akademik i Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, përgjegjës për programin e studimit MP në SIB ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e kurrikulës së këtij programi.</p> <p>Një rol kryesor ka pasur në këtë proces personeli akademik i planifikuar në mësimdhënien e lëndëve të programit. Hartimi i syllabuseve është bërë pas diskutimeve paraprake me specialistët e fushës, krahasimit me ato të institucioneve homologe, diskutimeve për përmbajtjen, literaturën, metodologjinë e mësimdhënies, përmbushjen e qëllimit të programit të studimit, etj. që kanë zhvilluar pedagogët e angazhuar drejtpërdrejt në mësimdhënie në këtë program. Korniza kurrikulare aprovohet në departament në përputhje me rregulloren e institucionit.</p>

	<p>Duke u mbështetur tek evidencat për rekrutimet e personelit akademik që na u vunë në dispozicion gjatë vizitës në institucion si edhe të dhënat për numrin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë që është paraqitur në tabelat 4 dhe 5 të Aneksit, të cilat janë në përputhje me standardet që përcakton ligji, mund të themi që rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe punonjësit e burimeve njerëzore u informuam se parimet, kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit akademik përcaktohen në Statut dhe në Rregulloren e UMSH.</p> <p>Konkurimi është i hapur dhe shpallja publikohet në faqen zyrtare në internet www.http://umsh.edu.al/njoftim-per-vende-vakante/, rrjetet sociale dhe në shumë raste edhe në shtyp e në televizion. Ngrihet një komision ad-hoc nga Rektori, i cili bën vlerësimin paraprak të kërkesave të paraqitura nga kandidatët. ZBNJ i përcjell Komisionit dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët. Më pas realizohet intervistimi i kandidatëve, hartohet raporti nga ana e Komisionit, i cili ja dërgon në formë propozimi për miratim Rektorit. Procedurat e rekrutimit që nga shpallja deri tek përzgjedhja e personelit janë të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit në nenet 24,25.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe Tabela 4 (Aneks) vërehet se PAE / Personel Akademik është mbi 85%, ndërsa kur gjykojmë mbi ngarkesën që PAE dhe PAK mbulojnë (Tabela 13 në Aneks), del se vetëm 1 lëndë me 5 kredite jepet nga PAK, pra $5 \text{ kredite} / 60 \text{ kredite} = 8.3 \%$ e ngarkesës mësimore të shprehur në kredite mbulohet nga PAK dhe 91 % e ngarkesës mbulohet nga PAE.</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e personelit, në takimet me grupet e ndryshme u raportua se personeli akademik në UMSH i nënshtrohet disa vlerësimeve gjatë vitit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi në linjë hierarkike, i cili përfshin: vetëvlerësimin, vlerësimin vertikal nga departamenti, dekanati dhe rektorati; • Vlerësimi i punës mësimore nga studentët; • Vlerësimi sipas procedurave nga NJSBCZHK. <p>Qëllimi i këtyre kontrolleve është rritja e nivelit akademik të mësimdhënies së personelit akademik. Rezultatet e vlerësimit të marra nëpërmjet pyetsorëve ose kontrolleve ju bëhen të ditura pedagogëve nëpërmjet një raporti që përmban përshkrimin e problemeve të konstatuara gjatë kontrollit dhe masat e rekomandimet</p>

	<p>përkatëse. Të gjitha këto bëhen në përputhje me procedurat ligjore dhe janë transparente.</p> <p>Pavarësisht se institucioni nuk përdorte ndonjë sistem elektronik specifik për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të personelit, të dhënat për aplikantët e rinj regjistroheshin elektronikisht në file të programit Ms-Excel dhe shfrytëzoheshin nga komisioni i vlerësimit gjatë fazave të konkurimit. Zyra e personelit dispononte të arkivuara dokumenta të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë etj.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor që është edhe përgjegjës për programin e studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” ka titullin “Doktor” të fituar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT dhe jo PhD në ndonjë universitet perëndimor jashtë Shqipërisë.</p>
<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p>Nga të dhënat e Tabelës 4 (Aneks) si dhe informacioni që morëm gjatë vizitës në institucion rezultojnë që titullarët dhe pedagogët e lëndëve të këtij programi studimi mbajnë së paku gradën shkencore Doktor. Janë 3 (tre) pedagogë të cilët kanë diplomën Msc dhe janë në proces doktrate duke pasur gjithashtu një eksperiencë 5 vjeçare në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe sipas dokumentacionit mbështetës që na u ofrua nga Zyra e Burimeve Njerëzore, si dhe mbështetur tek kontratat e punës që disponohen në dosjet përkatëse, rezultojnë se Kriteri 4 plotësohet.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Bazuar tek Tabela 4 (Aneks) si dhe tabela e strukturës didaktike të programit evidentojmë që personeli akademik efektiv mbulon të gjithë ngarkesën përsa i përket udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së praktikave profesionale.</p>

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës që na u ofrua për programin e studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”, Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor që është përgjegjës për këtë program ka parashikuar që marrja e diplomës në përfundim të studimeve të paraprihet nga një provim dhe jo përgatitje teze.</p>
<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	
<p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Rregullorja Institucionale, Rregullorja e FSHE, Rregullorja e Departamentit, si edhe ajo e programit të studimit MP në SIB, neni 13, përcakton se plotësimi i detyrimeve për punën kërkimore dhe tezën mund të shlyhet me provim përfundimtar.</p>

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MP në SIB përbëhet nga pedagogë me tituj e grada shkencore dhe me eksperiencë akademike. Si rrjedhojë, ata zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për udhëheqjen e tezave të diplomës së studentëve të përfshirë në këtë program studimi, nëse do të parashikohet që marrja e diplomës do të paraprihet nga mbrojtja e tezës. Kriteret, metodologjia, procedurat, afatet, detyrimet e palëve, në lidhje me punën për përgatitjen e tezës/diplomës, gjenden në Udhëzimin: "Për punimin e diplomës në programin Master Profesional".

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Në strukturën organizative të Fakultetit të Shkencave Ekonomike të UMSH, pjesë e personelit akademik efektiv të fakultetit është edhe pozicioni i laborantit. Në shërbim të procesit mësimor në të gjitha programet e ofruara nga fakulteti janë dy laborantë. Laboranti angazhohet në mirëmbajtjen e laboratorëve të pajisur me kompjutera që u ofrojnë shërbim interneti studentëve dhe mundësi për të punuar për nevojat mësimore.

Numri i burimeve njerëzore të angazhuara për realizimin e programit të studimit "MP në Sistemet e Informacionit në Biznes" është i mjaftueshëm për të përbushur objektivat e programit.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ngarkesa mësimore e personelit akademik është e përcaktuar në kontratën e punës që lidhet midis punëmarrësit dhe UMSH.

Sipas kësaj kontrate punëmarrësi përveç mësimdhënies e cila vlerësohet me orë mësimore, ka dhe detyra të tjera që janë kërkimi shkencor dhe veprimtari mbështetëse për institucionin. Ngarkesa mësimore vjetore planifikohet dhe pasqyrohet në fillim të çdo viti akademik sipas Rregullores së institucionit. Kjo ngarkesë mësimore vlerësohet me orë mësimore.

Bazuar tek dokumentat e vënë në dispozicion nga institucioni ngarkesa mësimore maksimale për vitin akademik 2017-2018 rezulton të jetë 270 orë mësimore për personel akademik me diplomë Msc e cila vjen në ulje për tituj dhe grada më të larta, ngarkesë e cila ruan cilësinë e mësimdhënies.

Pranë këtij programi studimi, cdo pedagog është i angazhuar vetëm në 1 lëndë.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Gjatë vizitës në institucion, ZBNJ na vuri në dispozicion gjithë dokumentacionin e hollësishëm të anëtarëve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në “Sistemet e Informacionit në Biznes”, si atë të personelit efektiv edhe atë me kontratë. Ky dokumentacion konsiston në një arkiv të dosjeve të personelit me materiale të printuara.

Drejtuksi i Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor na informoi se ky departament, si njësi akademike përgjegjëse për programin e studimit MP në SIB, çdo fillim semestri harton listën e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Këto lista më pas dorëzohen dhe ruhen në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për ruajtjen e rekordeve të të gjithë punonjësve në nivel institucional. Gjithashtu në këtë zyrë gjendeshin edhe

dokumentacionet e nevojshme për personelin administrativ. Kjo listë e plotë e personelit akademik të UMSH, gjendet gjithashtu e publikuar në faqen zyrtare on-line të institucionit shoqëruar me një biografi të shkurtër për secilin.

Drejtuksit na informuan se kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik përcaktohen në statutin e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”, në rregulloren Institucionale Kreu V, Neni 38,39 si dhe publikohen në internet dhe media në rast të vendeve vakante. Këtë gjë e pohuan edhe pedagogët e rinj të rekrutuar së fundmi të cilët ishin informuar nëpërmjet web-it për mundësinë e punësimit në UMSH. Një dokument përmbledhës i procedurës së rekrutimit hartuar nga zyra juridike e UMSH na u vu gjithashtu në dispozicion.

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1. Personeli akademik dhe administrativ i institucionit në bazë të kontratës së punës që nënshkruan angazhohet në përputhje me objektivat e programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes”, të cilat janë hartuar në përputhje “Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Programi MP në SIB” si dhe me “Strategjinë e UMSH”.**
- 2. Hartimi i kurrikulës së programit të studimit është bërë me pjesëmarrjen e personelit akademik të Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, dhe kryesisht të personelit akademik të angazhuar drejtpërdrejt në mësimdhënie në këtë program studimi. Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore është bërë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe nevojave të institucionit.**
- 3. Procedurat e rekrutimit që nga shpallja deri tek përzgjedhja e personelit janë të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit në nenet 24, 25. Mbi 85% e ngarkesës mësimore në programin e studimit MP në SIB realizohet nga personel akademik efektiv. Zyra e personelit dispononte të arkivuara dokumenta të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë, etj. Performanca e personelit vlerësohet periodikisht.**
- 4. Bazuar tek Tabela 4 (Aneks) si dhe tabela e strukturës didaktike të programit**

evidentojmë që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i pajisur me titujt/gradat dhe eksperiencën e nevojshme për të përmbushur nevojat e institucionit për realizimin e programit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

5. Për vitin akademik 2017-2018 gjatë të cilit është çelur për herë të parë programi i studimit MP në SIB është parashikuar që plotësimi i detyrimeve për punën kërkimore dhe tezën, që do të shlyhet me provim përfundimtar, bazuar kjo tek Rregullorja Institucionale, Rregullorja e FSHE, Rregullorja e Departamentit, si edhe ajo e programit të studimit MP në SIB, neni 13.
6. Në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi ka dy laborantë të cilët mbështesin nevojat e tyre në përdorimin e laboratorëve të informatikës gjatë procesit mësimor. Numri i burimeve njerzore, si personel akademik administrativ, të angazhuara për realizimin e programit të studimit MP në SIB është i mjaftueshëm për të përmbushur objektivat e programit.
7. Ngarkesa mësimore e personel akademik përcaktohet që në kontratën e punësimit, në mbështetje të nevojave të programit të studimit dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
8. Zyra e Burimeve Njerzore disponon gjithë dokumentacionin e hollësishëm të anëtarëve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në SIB. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik përcaktohen në statutin e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”, në Rregulloren Institucionale si dhe publikohen në internet dhe media në rast të vendeve vakante.

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ushtron veprimtarinë në ambiente me një sipërfaqe shfrytëzimi 3860 m². Konkretisht këto ambiente ndodhen në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52, Kodi Postar: 1023, Tiranë. Godina përbëhet nga 6 nivele: 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë. Godina është një ndërtim relativisht i ri. Ndërtimi i saj ka përfunduar në vitin 2010, është marrë me një kontratë qeraje mbi 10 vjeçare, dhe ofron mjedise optimale për plotësimin e nevojave të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore për studentët dhe për personelin akademik.

Në funksion të studentëve në të gjithë hapësirat e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” është instaluar interneti Wireless (WiFi) me shërbim 24 orë.

Ambjentet e bibliotekave dhe leximit kanë disa hapësira që variojnë nga 20, 30, 17- dhe 90 m², të cilat janë të pajisura me një sasi të konsiderueshme titujsh librash dhe tekstesh universitare, si dhe revista shkencore, e materiale të tjera shkencore. Biblioteka Online e UMSH ka mbi 327,325 tituj librash.

Të dhëna të tjera për mjediset e shërbimit për studentët janë paraqitur në Tabelën 7 në Aneks dhe në dokumentat e vëna në dispozicion online. Pavarësisht se treguesit e matshëm për infrastrukturën janë në rang institucioni dhe fakulteti, ato shfrytëzohen maksimalisht për realizimin e programit të studimit MP në SIB për arsye se oraret e zhvillimit të mësimit për këtë program janë vendosur pas orës 17.00 nga e Marta në të Shtunë, dhe nuk ka përplasje me programet e tjera të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

• Salla për leksione	6
• Klasa për seminare	15
• Salla për aktivitete promovuese	1
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	0
• Laboratorë për lëndët	0
• Laboratorë informatike	3
• Salla interneti	1
• Salla për bibliotekë	4
• Mjedis për fotokopjime, librari, etj	1
• Zyrë informacioni për studentët	1
• Nyje hidrosanitare	53

Mjediset për personelin akademik:

• Mjedise për Dekanin/ kancelarin	7
• Zyra për sekretarinë mësimore	3
• Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	8
• Zyra për personelin akademik	2

Në Tabelën 7 në Aneks jepen të dhëna shtesë sasiore për infrastrukturën, logjistikën, shërbime të tjera, etj., të Fakultetit të Shkencave Ekonomike përgjegjës për programin MP në SIB.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në institucion u vizituan konkretisht një pjesë e sallave ku zhvillohen leksionet, dy laboratore, biblioteka, disa nga zyrat e personelit administrativ, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>UMSH ka një vendndodhje të përhershme në ambiente me një sipërfaqe shfrytëzimi 3860 m². Konkretisht këto ambiente ndodhen në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52, Kodi Postar: 1023, Tiranë.</p> <p>Këto mjedise janë marrë me qera nëpërmjet një kontrate për një periudhë më shumë se 10 vjeçare.</p> <p>Programi i studimit MP në SIB ofrohet vetëm në këtë godinë e cila i plotëson të gjitha nevojat për realizimin e procesit mësimor dhe të gjitha aktiviteteve në ndihmë të tij.</p>

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

UMSH ka vënë në dispozicion të studentëve të programit MP në SIB tekste mësimore të hartuara nga pedagogë të huaj si dhe nga ata më me emër të universiteteve të tjera në vend. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara ose prezantimet në Power Point zënë një vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përpjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore.

Gjatë vizitës në bibliotekë evidentuam se ofrohen për studentët të gjitha materialet mësimore të programit të studimit MP në SIB, sipas literaturës që ofrojnë syllabuset e lëndëve, në format elektronik ose të printuara.

Biblioteka përmbante mbi 4000 tituj librash dhe tekstesh universitare të ndara sipas drejtimeve kryesore që përkojnë me fushat e programeve të studimit që ofron institucioni, prej të cilave numërohen mbi 900 tituj të ndryshëm në fushat e Ekonomisë, Informatikës dhe Formimit Shkencor, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve vihen në dispozicion të programit të studimit MP në SIB.

Në UMSH përgjegjësi i programit të studimit MP në SIB është në kontakt të vazhdueshëm me pedagogët e lëndëve duke synuar përditësimin e literaturës së përdorur dhe shtimin e zërave të bibliotekës, duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.

Universiteti qëndron i hapur nga ora 8.30 deri në orën 19.30. Për këtë arsye, për t'i qëndruar sa më afër kërkesave dhe nevojave të studentëve është vendosur që biblioteka të punojë me të njëjtin orar. Gjatë kësaj kohe një punonjës i bibliotekës qëndron gjithnjë në dispozicion të studentëve për orientimin e tyre në të. Orari i punës së Bibliotekës është i shpallur në hollin e katit të parë dhe në hyrje të Bibliotekës.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për

Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor përgjegjës për programin e studimit MP në SIB disponon një sasi të mjaftueshme mjedisesh të pajisura me mjete të Teknologjisë së Informacionit, për realizimin e këtij programi studimi. Disponohen 6 salla leksionesh, 15 seminaresh, 2 laboratorë me kompjutera, zyra dhe mjedise të tjera. Një avantazh ka sjellë koordinimi i orareve të mësimin, të cilat janë pas orës 17.00, në përputhje me nevojat e studentëve dhe disponueshmërinë e mjedisëve.

Laboratorët e informatikës janë të pajisur me kompjutera, sistem audio, videoprojektor dhe

<p>secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>internet.</p> <p>Për plotësimin e kërkesave që ka programi i studimit MP në SIB studentët mund të përdorin në laborator programe të ndryshme informatike editorë dhe aplikacione të tjera si: Notepad++, Dev C++, Sublime Text, Sistemi i Integruar Eclipse, Microsoft Visual Studio 2005, XAMPP, dhe shumë mjete (tools) të tjera që shërbejnë për programim në C++, Java, PHP, Javascript, HTML, CSS, MySQL, Alfa, Financë 5, Bilanc Standard, SPSS, etj.</p> <p>Për këtë program studimi përdoren dy laboratorë informatike duke pasur parasysh që avantazh ka sjellë koordinimi i orareve të mësimit, të cilat janë pas orës 17.00, në përputhje me nevojat e studentëve dhe disponueshmërinë e mjediseve. Gjithashtu edhe numri i vogël i studentëve, vetëm 15 (një grup leksioni) bën që mjediset e punës të shfrytëzohen maksimalisht.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1. UMSH ka një vendndodhje të përherëshme në ambiente me një sipërfaqe shfrytëzimi 3860 m², të cilën e ka marrë me qera nëpërmjet një kontrate për një periudhë më shumë se 10 vjeçare. Infrastruktura është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit MP në SIB.**
- 2. Në shërbim të studentëve të MP në SIB është biblioteka e cila ofron të gjitha materialet mësimore të programit të studimit MP në SIB, sipas literaturës që ofrojnë syllabuset e lëndëve, në format elektronik ose të printuara. Gjithashtu në dispozicion të tyre është dhe biblioteka online e UMSH me mbi 327,325 tituj librash. Biblioteka qëndron e hapur gjatë gjithë kohës që studentët janë në mjediset e universitetit në përshtatje me oraret e tyre të mësimit.**
- 3. Në funksion të programit të studimit MP në SIB janë vënë dy laboratorë të pajisura me kompjutera, sistem audio, videoprojektor dhe internet. Për plotësimin e kërkesave që ka programi i studimit MP në SIB studentët mund të përdorin në laborator programe të ndryshme informatike editorë dhe aplikacione të tjera.**

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është projekt i OJF “Qendra Mesdheu”. OJF “Qendra Mesdheu” është regjistruar me Vendim Nr. 411, datë 06.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si person juridik dhe si objekt të aktivitetit ka realizimin e ushtrimit të aktivitetit në fushën e arsimit të lartë privat dhe kërkimit shkencor, dhe rezulton në Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. (Ligji Nr. 8788, “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” dhe Ligji nr. 8789, “Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”). Referuar nenit 24 të Statutit dhe nenit 15 të Rregullores Organizative të UMSH, Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal




Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i "Qendra Mesdheu" është autoriteti i cili emëron anëtarët e Bordit të Administrimit.

Rezultatet e financimit, menaxhimit dhe administrimit të UMSH pasqyrohen në Pasqyrat Financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme për vitin 2017 (në mijë lek):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Tabela 8 në Aneks pasqyron të ardhurat dhe financimet e ndryshme në nivel institucional (në mijë lek).

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në mijë lek):

Tabela 8/1 në Aneks pasqyron shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në mijë lek) në nivel institucional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u pohua se kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të institucionit. Auditimi i Brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 32, Rregullore Organizative e UMSH). Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertët e jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Crowe Horwath AL sh.p.k.</p> <p>Në mungesë të paraqitjes së raporteve të auditit për arsye konfidenciale, bazuar tek dokumentacioni që na u vunë në dispozicion, të dhënat për grantet, kontratat e shërbimeve, etj., gjenden në Tabelën 8 në Aneks.</p> <p>Duke u mbështetur tek informacionet që morëm gjatë vizitës në institucion mund të themi që në mënyrë periodike, Bordi i Administrimit kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve duke e përvijuar në mënyrë eksplicite drejtimin e saj për rritjen e cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimin e personelit akademik (duke zhvilluar një sistem pagesash</p>

	dhe rekrutimesh mbi baza cilësie), investimin në përmirësime infrastrukturore të rëndësishme që lidhen me kushtet e punës dhe mësimdhënien si dhe operimin me sisteme moderne të zhvillimit të aktiviteve mësimore dhe shkencore.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Në mungesë të pasyrave financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve por duke u mbështetur tek informacionet që morëm gjatë vizitës në institucion mund të themi që UMSH si projekt i OJF “Qendra Mesdheu” dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të cilat i paraqiten Bordit të Adminis. në çdo vit.</p> <p>Duke u mbështetur tek informacionet që morëm gjatë vizitës në institucion mund të themi që UMSH ka demonstruar me anë të ecurisë së shumë treguesve të rëndësishëm që kanë të bëjnë me rritjen e institucionit gjatë këtyre viteve të funksionimit, që ka një qëndrueshmëri financiare në gjenerimin e të ardhurave dhe vijueshmërisë së aktivitetit.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Bazuar tek informacionet e marra në institucion mund të themi që kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm që emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertët e jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Crowe Horwath AL sh.p.k.. 2. Duke u mbështetur tek informacionet që morëm gjatë vizitës në institucion mund të themi që UMSH si projekt i OJF “Qendra Mesdheu” dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të cilat i paraqiten Bordit të Administrimit në çdo vit. 	
<u>Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.</u>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) dikur si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Rregullorja e NJSBCZHK është hartuar mbi bazën e:

- Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Datë 22.07.2015; Neni 103 dhe 104.
- Statutit të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”; Neni 53 dhe 84, dhe në rregulloren e UMSH Neni 28.

- Dokumentave të ASCAL-it.

Rregullorja përcakton procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional dhe programesh studimi në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe standardet e udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe të vlerësimit të cilësisë së punës, të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor e shërbimeve të tjera në UMSH.

Në bazë të Nenit 3 të Rregullores, NJSBCZHK përbëhet nga 7 anëtarë, Tabela 9 në Aneks, që kanë mandat 3 vjeçar dhe aprovohen nga Senati.

Subjektet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në UMSH janë personeli akademik, personeli akademik ndihmës mësimor-shkencor, personeli joakademik, studentët dhe personeli akademik administrativ. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave harton një raport vjetor të punës së saj dhe ja paraqet Rektorit i cili bën vlerësimin e punës së saj. Të gjitha raportet përfundimtare protokollohen dhe arshivohen, në përputhje me aktet juridike të institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit MP në SIB, si:

o Sa anketime kanë bërë me studentët?

Në përgjithësi anketimet kryhen 2 herë në vit në të gjitha lëndët që zhvillohen gjatë vitit akademik, përkatësisht semestrave mësimore. Për këtë program studimi është kryer vetëm një anketim në sezonin e dimrit, meqë ky program është hapur për herë të parë në vitin akademik 2017-2018.

o Sa studentë janë anketuar?

Në parim në anketim studentët marrin pjesë sipas dëshirës, por numri minimal i lejuar nuk është më i vogël se 60% e studentëve të programit të studimit. Nga informacioni që morëm për këtë program studimi kishin marrë pjesë rreth 90% e studentëve.

o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?

Të gjitha anketat e plotësuara përpunohen nga NJSBCZHK. Në rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për tu përpunuar. Nga informacioni që morëm për këtë program studimi nuk kishin dalë probleme gjatë përpunimit.

o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?

Rezultatet e anketimit i jepen rektoratit dhe dekanatave. Këto rezultate pastaj diskutohen veçmas me çdo pedagog me qëllim përmirësimin e çështjeve që kontestohen nga ana e studentëve.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Bazuar tek Rregullorja e Brendëshme për Organizimin dhe Punën e NJSBCZHK, Neni 9 përcakton mënyrën e Planifikimit dhe Organizimit të Vlerësimit të Brendëshëm të Cilësisë. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të UMSH dhe harton Raportet përkatëse. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendëshme të UMSH.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Bazuar tek Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Nenin 1 përcaktohen Përgjegjësit kryesorë për cilësinë në nivel institucional të cilët janë: Senati, Rektori, Njësia e Sigurimit të

Brendshëm të Cilësisë, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm në çdo fakultet dhe Dekanët, të cilët lidhen dhe raportojnë në mënyrë hierarkike në këtë proces. GVB-të i raportojnë NJSBC për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë dhe për progresin e realizuar në bazë të regullt. Takohen së paku dy herë në vit. Personeli akademik, studentët dhe palët e interesuara inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e modeleve vlerësuese si dhe në rishikimin e tyre.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Gjatë vetëvlerësimeve të kryera një vend të rëndësishëm kanë zënë rezultatet e marra nga përpunimi i pyetsorëve të studentëve. Ato kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qënë ato të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve. Gjithashtu mund të themi që kurrikula, larmia e lëndëve, ndihma e pedagogëve jashtë orës së mësimi, projektet praktike ku përfshihen edhe studentët janë asetet më të vlerësuara të programit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar tek Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Nenin 8 përcaktohen Sugjerimet për Rritjen dhe Sigurimin e Vazhdueshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. NJSBCZHK mbi bazën e vlerësimeve periodike që bën jep sugjerime për përmirësimin e punës për rritjen dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë për të ardhmen në drejtimet e përcaktuara në këtë Nen, duke ndjekur metodologji të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p>	<p>UMSH harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare (Neni 3 i Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë). Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. NJSBCZHK harton një plan rreth përdorimit të instrumentave të ndryshme të monitorimit të cilësisë dhe të metodologjisë së vlerësimit të rezultateve të marra nga kontrollet të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketimet me studentët. • Vetvlerësimi që plotësohet fillimisht nga personeli akademik dhe pastaj nga eprorët. • Vizitat në auditor. <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave harton një raport vjetor të punës së saj dhe ja paraqet Rektorit i cili bën vlerësimin e punës së saj. Të gjitha raportet përfundimtare protokollohen dhe arshivohen, në përputhje me aktet juridike të institucionit.</p>

<p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kurse për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Sipas Nenit 3 të Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC përgatit Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet përmbajnë sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë dhe shpallen publikisht.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor këto metoda:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve; • Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; • Pyetje konceptuale; • Intervista; <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjime në auditor; • Vlerësimi me pikë; • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; • Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;
---	---

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Bazuar tek Rregullorja e Brendëshme për Organizimin dhe Punën e NJSBCZHK, Neni 9, NJSBC harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe brenda 10 ditëve ja paraqet Rektorit. Këto raporte dhe broshurat e programve janë pjesë e diskutimit në rektorat dhe në departament. Të gjitha raportet përfundimtare protokollohen dhe arshivohen, në përputhje me aktet juridike të institucionit. Raporti i vlerësimit periodik ju vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Sipas Nenit 3 të Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC përgatit Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit dhe e shpall publikisht. Në faqen e web-it të UMSH gjenden vetëm RVJ e vitit 2012.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave harton një raport vjetor të punës së saj dhe ja paraqet Rektorit i cili bën vlerësimin e punës së saj dhe aprovon planin që bëhet nga kjo njësi për vitin e ardhshëm

<p>programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>akademik.</p> <p>Sipas Nenit 10 të Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raportet e NJSBC si dhe ato që dalin nga diskutimet në fakultete, i dërgohen Rektorit, Senatit dhe Anëtarëve të Bordit. Senati/Bordi i UMSH merr vendimet përkatëse të cilat reflektohen në Planin Strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të UMSH.</p> <p>Programi i studimit MP në SIB është çelur për herë të parë gjatë këtij viti akademik (2017-2018), në përfundim të tij (Tetor-Nëntor 2018) parashikohet realizimi i një analize vjetore, e cila do të vlerësojë ecurinë e këtij programi. Rezultatet e kësaj analize, do t'i shërbejnë UMSH për të marrë masat e duhura për të përmirësuar diçka në vitin pasues akademik.</p>
---	---

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UMSH ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Urdhër të MASH Nr. 124, datë 29.03.2012.</p> <p>Institucioni përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë nëpërmjet njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave (NJSBCZHK) e cila është ngritur mbi bazën e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Datë 22.07.2015; Neni 103 dhe 104. • Statutit të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”; Neni 53 dhe 84, dhe në rregulloren e UMSH Neni 28. • Dokumentave të ASCAL-it. <p>Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UMSH harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.</p> <p>Institucioni harton mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Punën e NJSBCZHK dhe në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë nëpërmjet trajnimeve të ndryshme deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e</p>
---	---

veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UMSH me fillimin e vitit akademik dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.

Strategjia, politika dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë publikuar dhe zbatohen nga strukturat drejtuese dhe NJSBC dhe reflektohet nëpërmjet raporteve periodike mbi bazën e të cilave Senati/Bordi i UMSH marrin vendime të cilat reflektohen në Planin Strategjik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të UMSH.

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1. UMSH është akredituar në nivel institucional me Urdhër të MASH Nr. 124, datë 29.03.2012.**
- 2. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë duke u mbështetur tek Ligji i AL, Statuti i UMSH dhe dokumentat e ASCAL.**
- 3. UMSH harton politika për të siguruar cilësinë e proceseve akademike duke i miratuar ato në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.**
- 4. Mekanizmat për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit përcaktohen në Rregulloren e Brendëshme për Organizimin dhe Punën e NJSBCZHK dhe në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**
- 5. Institucioni vazhdimisht ndërmer fushata ndërgjegjësimi dhe nisma trajnimi/informimi për personelin akademik dhe studentët për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë.**
- 6. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë institucioni harton strategji dhe ndjek procedura nëpërmjet strukturave drejtuese dhe NJSBC.**

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i programit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” është: “Të zhvillojë njohuritë thelbësore të informatikës së biznesit që lidhen kryesisht me dizejnimin dhe zbatimin e sistemeve të reja informatike që ndërthuren me teknologjinë e informacionit, biznesin, dhe ekonominë”.

Objektivi kryesor i programit të studimit “MP në Sistemet e Informacionit në Biznes” është “Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqiptar”.

Ky program studimi është ideuar dhe po realizohet në mënyrë të tillë që të kontribuojë në formimin e specialistëve të rinj dhe në ri-kualifikimin e të diplomuarve në vitet e mëparshme, që kanë nevojë për specializim të mëtejshëm në fushën Informatikë Biznesi.

Për përfitimin e diplomës “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, studentët duhet të marrin 60 kredite, të cilat normalisht duhet të përmbushen brenda një viti akademik, i shtrirë në dy semestra. Organizimi i vitit mësimor zhvillohet konform akteve dhe rregullave në fuqi, që përcaktojnë ngarkesën në auditorë dhe jashtë tyre, sipas krediteve përkatëse të çdo lënde. Plani mësimor për këtë program siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave. Në përfundim të programit studentit i jepet diploma “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master Profesional në SIB është aktiv në vitin akademik 2017 – 2018. Objektivat e tij janë:

- informim dhe kërkim i vazhdueshëm në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ekonomisë.
- krijimin dhe përhapjen e ideve të reja dhe të dobishme për shoqërinë në tërësi dhe komunitetin akademik në veçanti.
- idejimin, ndërtimin dhe vendosjen në praktikë të sistemeve dhe programeve sipas trendeve më të fundit në fushën e telnologjisë së informacionit dhe ekonomisë.

Në këtë mënyrë, ky program siguron përgatitjen e një brezi të ri programuesish, analistësh dhe manaxhuesish projektësh të cilët janë të gatshëm të përthithen direkt nga tregu i punës në Shqipëri e më gjerë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela nr. 10 e plotësuar në Aneks)

Bazuar në misionin dhe objektivat e programit të studimit është hartuar edhe plani mësimor. Ndërtimi i programit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, është mbështetur në eksperiencat më pozitive të universiteteve ndërkombëtare e vecanërisht të Eindhoven Technology në Hollandë. Ai përmban njëkohësisht edhe elemente të vecantë të programeve të përafërta të zhvilluara nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

Programi është ndërtuar me sistemin e 60 krediteve nga të cilat 44 përfitohen me marrjen e 7 lëndëve, një prej të cilave është me zgjedhje në tre opsione. Programi është fokusuar kryesisht në elementë të përdorshëm praktik të nevojshëm sidomos për biznesin e mesëm dhe të vogël dhe synon përfshirjen sa më të shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës. Ky program është ndërtuar në dy shtylla kryesore, në Analizë dhe Projektim të Sistemeve të Informacionit si edhe në Analizë dhe Projektim i Bazave të të Dhënave. Këto dy lëndë përbëjnë themelet teorike të të gjithë mekanizmave praktik që mësohen në lëndët e tjera. Në këtë mënyrë, realizohet lidhja horizontale me lëndën e Programimit të Avancuar në Web, E-Biznes Studime të Thelluara dhe Siguria e Sistemeve të Informacionit. Një vend të veçantë zë dhe Komunikimi i të Dhënave në Biznes, element ky shumë i nevojshëm për të thelluar më tej njohuritë e marra në Bachelor në fushën e rrjetave.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | | |
|------------------------------|--------------------------|--|
| ▪ Për leksionet | 10 orë në auditor dhe | 15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7.5-8 orë në auditor dhe | 16.5-17 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 15 orë në auditor dhe | 10 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 0 orë në auditor dhe | 125 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 120 orë në auditor dhe | 155 orë punë e pavarur e studentit |

Shpërndarja e krediteve për çdo formë studimi i përshtatet më se miri një programi studimi master profesional, ku laboratoreve u jepet një rëndësi e madhe.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka ndryshime në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela nr. 13 e plotësuar në Aneks)

Kriteri lidhur me raportin e personelit akademik efektiv me personelin akademik me kontratë është 70% me 30% e mbulimit të programit. Për këtë program studimi, nisur nga planet mësimore si dhe kontratat e personelit akademik të konsultuara pranë zyrës së burimeve njerëzore, vetëm 1 prej 7 lëndëve mbulohen me personel akademik PAK e pjesa tjetër e lëndëve të programit MP në SIB mbulohet me personel akademik efektiv, duke ruajtur kriterin ku mbi 70% e programit duhet mbuluar me PAE.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Në syllabus-et e hartuara për lëndët e programit të studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, janë pasqyruar të gjitha elementet e kërkuara.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në aspektin formal, syllabuset e lëndëve për programin e studimit MP në SIB kanë të pasqyruara elementët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

Procedura që ndiqet për hartimin dhe miratimin e syllabuseve është e njëjtë në nivel institucioni. Syllabusi paraqitet në departament nga titullari i lëndës. Përpara miratimit të syllabuseve nga

përgjegjësi i njësisë bazë, ato trajtohen paraprakisht në gruplëndët përkatëse dhe në mbledhje departamenti. Në këto takime analizohen elementët e mëposhtëm:

- përputhja e plotë me planin mësimor, bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga IAL-ja si dhe kërkesat të tregut të punës;
- modernizimi i literaturës, përshtatja e temave të trajtuara mes formimit teorik të lëndëve dhe zbatimit praktik të tyre;
- përshtatja e metodave të vlerësimit dhe ndërtimi i procedurave të barazvlerësimit
- rrjedhja logjike e informacionit, shmangia e përsëritjeve si edhe njohurive paraprake që duhet të ketë studenti.

Kjo procedurë kryhet cdo fillim viti akademik. Gjithashtu, departamenti bashkërendon punën edhe me departamentet e tjerë për lëndët që mbulohen prej tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” i ofruar nga UMSH është i organizuar në module të vlerësuara në kredite, sipas sistemit European, të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Cikli i këtij programi shtrihet në 1 vit akademik, i cili realizohet me përbushjen e 60 krediteve (ETCS).</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë</p>	<p>Programi i studimit “Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” është vazhdim i ciklit të parë të studimit Bachelor “Informatikë Biznesi” si dhe një pasurim i dijes së studentit me njohuri të thelluara teorike dhe praktike.</p> <p>Programi Master Profesional i orjenton dhe i aftëson studentët për të zotëruar dije dhe aftësi të mirëfillta profesionale e teorike, për ti hapur rrugë kështu punësimit e më tej. Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor që është përgjegjës për këtë program ka parashikuar që marrja e diplomës në përfundim të studimeve të paraprihet nga një provim dhe jo përgatitje teze.</p> <p>Në përfundim të këtij programi studenti aftësohet si specialist i larte i Sistemeve të Informacionit në Biznes.</p> <p>Programi “Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” synon paisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqipëtar. Në këtë mënyrë, ky program siguron përgatitjen e një brezi të ri programuesish,</p>

<p>doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>analistësh dhe manaxhuesish projektsh të cilët janë të gatshëm të përthithen direkt nga tregu i punës në Shqipëri e më gjerë. Ata mund të punojnë si specialist dhe vendimarrës të sistemeve të informacionit në biznes, në veprimtaritë publike e private, në banka, në sektore financiar, në administratë, në OJF dhe në shoqëri tregëtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialist i parë IT në institucionet financiare • Specialist i parë Rrjetash • Specialist i parë Databaze • Drejtues të përgjithshëm apo sektorialë të bizneseve private e publike të llojeve të ndryshme, biznese kombëtare e ndërkombëtare. • Dizenjues dhe mirmbajtës të faqeve web si për shoqëri tregëtare, ashtu edhe për administratën shtetërore.
---	---

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” ka si qëllim paisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për ndërtimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit në subjektet e biznesit të tregut shqipëtar.</p> <p>Objektivat e programit të studimit synojnë arritjen e këtij qëllimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – informim dhe kërkim i vazhdueshëm në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ekonomisë. – krijimin dhe përhapjen e ideve të reja dhe të dobishme për shoqërinë në tërësi dhe komunitetin akademik në veçanti. – idejimin, ndërtimin dhe vendosjen në praktikë të sistemeve dhe programeve sipas trendeve më të fundit në fushën e telnologjisë së informacionit dhe ekonomisë. <p>Duke marrë në konsideratë të gjitha pikat e lartpërmendura, ky program siguron përgatitjen e një brezi të ri programuesish, analistësh dhe manaxhuesish projektsh të cilët janë të gatshëm të përthithen direkt nga tregu i punës në Shqipëri e më gjerë.</p> <p>Me qëllim përmbushjen me sukses të objektivave të programit, përdoren metoda vlerësimi të studentëve që të sigurojnë kontroll të vazhdueshëm të njohurive si psh. angazhimi i studentëve në orët e seminareve, nxitja e mendimit kritik tek studentët me anë të projekteve të ndryshme apo detyrave të kursit si edhe performancës në provimin përfundimtar.</p>
---	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Programi i studimit "Master Profesional në Sistemet Informacioni në Biznes", është mbështetur në eksperiencat më të mira të universiteteve ndërkombëtare e veçanërisht të Eindhoven Technology në Hollandë.

Sipas hartuesve të programit mësimor, tre janë elemente bazë që janë marrë parasysh:

- ndryshimi i kërkesës së tregut të punës në Shqipëri dhe në Ballkan
- mundësinë e transferimit të krediteve brenda tregut universitar shqiptar
- mundësinë e vetpunësimit dhe rritjen e frymës së sipërmarrjes private në edukimin universitar.

Programi i studimit "Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes" është ndërtuar në përputhje me objektivat dhe në marrëveshje dypalëshe janë përcaktuar procedurat për ekuivalentimin e pjesëshëm të programeve. Ky proces ka prekur unifikimin e ndërtimit të syllabusit, unifikimin e procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe unifikimin e kontrolleve mësimore. Universiteti është ende në fazën fillestare të këtij procesi, por ky proces është i rëndësishëm për realizimin e objektivave afat-shkurtra dhe afatmesme për këtë program.

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.

Programi i studimit "Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes" përmban dy komponentë, dy komponentë: aftësimin profesional të cilin e zhvillon mbi bazën teorike të zhvilluara brenda auditorit, por edhe praktikën, e vendosur jo pa qëllim përpara fazës së diplomimit të studentëve.

Programi i studimit është në përputhje me profilin e UMSH, duke krijuar një lidhje harmonike të fakulteteve me strategjinë e tij për zhvillim.

Kërkimi shkencor që kryhet nga personeli akademik, ka si qëllim përsosmërinë e vazhdueshme të programit në arritjen e qëllimit të tij.

Që nga hapja e programit e deri tani, janë angazhuar si PAE në departament profesor dhe doktorantë fusha e kërkimit të të cilëve përputhet mjaft mirë me këtë program studimi. Gjithashtu edhe dy prej anëtarëve të personelit akademik të departamentit Informatikë dhe Formim Shkencor kanë nisur studimet doktorale pranë universiteteve franceze e gjermane në fusha kërkimi të cilat vihen në funksion të këtij programi studimi si edhe

	programeve të tjera që ofron njësia bazë.
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit MP në SIB në UMSH është hartuar në mënyrë të tillë që, jo vetëm t’u përgjigjet, por edhe t’u paraprijë nevojave që paraqet tregu i punës në Shqipëri, rajon e më gjerë. Ky program studimi ka si qëllim kryesor përgatitjen e profesionistëve të rinj në këtë drejtim, çka nënkupton se të diplomuarit do të kenë gjithë kriteret e nevojshme për të qenë pjesë e personelit akademik të të punësuarve në çdo subjekt tregu në këtë profil. Ata mund të punojnë si specialistë dhe vendimarrës të sistemeve të informacionit në biznes, në veprimtaritë publike e private, në banka, në sektore financiar, në administratë, në OJF dhe në shoqëri tregtare.</p> <p>Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ekspert IT në institucionet financiare ➤ Ekspert Rrjetash ➤ Ekspert Databaze ➤ Drejtues të përgjithshëm apo sektorialë të bizneseve private e publike të llojeve të ndryshme, biznese kombëtare e ndërkombëtare. ➤ Dizenjues dhe mirëmbajtës të faqeve web si për shoqëri tregtare, ashtu edhe për administratën shtetërore.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Hapja e programit të studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, u parapri nga një studim tregu i kryer nga Qendra “Mesdheu”. Në këtë studim janë evidentuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, si dhe atë kombëtar e ndërkombëtar; b. Kërkesat e punëdhënësve; c. Një parashikim i përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. Numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. <p>UMSH ka planifikuar të kryejë një studim vlerësues me përfundimin e një cikli të plotë të realizimit të programit të studimit (Tetor-Nëntor 2018)</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>UMSH është bazuar në politikat e promovuara mbi bazën e interesit kombëtar dhe politikave prioritare të zhvillimit social e ekonomik të vendit në përgatitjen dhe ngritjen e programeve.</p> <p>Korniza kurrikulare e programit Master Profesional në SIB është ndërtuar në përputhje me interesat gjeopolitike kombëtare, rajonale në kuadrin e integritit të vendit në Bashkimin European.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>UMSH ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite ECTS.</p> <p>Programi i studimit "Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes", realizohet me 60 kredite europiane ECTS në total, ku përfshihet edhe projekti kërkimor dhe teza (provimi) që duhet dhënë, në përfundim të ciklit të studimeve me kohëzgjatje 1 vit akademik.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët që studiojnë pranë UMSH, por gjithkush që është i interesuar në këtë program studimi, mund të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi modulet dhe syllabuset në faqen zyrtare online në internet të UMSH. Studentët, këtë informacion të paraqitur në mënyrë të detajuar, e marrin edhe në portalin e çdo pedagogu titullar të lëndëve.</p> <p>Në fillim të cdo viti, por edhe gjatë vitit, pedagogët tutorë të secilit prej grupeve, u ofrojnë studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm ku përfshihen edhe syllabuset. Gjithashtu informacioni mund të tërhiqet në formë të shkruar pranë sekretarisë mësimore.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>UMSH ka krijuar një udhëzues për punimin e diplomës si dhe një formular për vlerësimin e saj.</p> <p>Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor që është përgjegjës për këtë program ka parashikuar që marrja e diplomës në përfundim të studimeve të paraprihet nga një provim dhe jo përgatitje teze. Rregullorja Institucionale, Rregullorja e FSHE, Rregullorja e Departamentit, si edhe ajo e programit të studimit MP në SIB, neni 13, përcakton se plotësimi i detyrimeve për punën kërkimore dhe tezën mund të shlyhet me provim përfundimtar.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Programi i studimeve MP në SIB i ofruar nga UMSH është në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, në përputhje me strategjinë për zhvillim të UMSH si dhe</p>	

synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

2. Programi i studimeve MP në SIB është në përshtatje me nivelin e studimeve dhe synon të arrijë dimensione ndërkombëtare.
3. Programi i studimeve MP në SIB përfshin aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor si dhe merr parasysh nevojat e tregut të punës.
4. UMSH siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programin e studimeve MP në SIB si ka të parashikuar një plan diplomimi për studentët e tij.

Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies në UMSH bazohet në kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe në eksperiencat më të mira, si të vendit ashtu edhe ato ndërkombëtare. Programi i studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” përmban disiplina formuese, karakterizuese, integruese dhe mbështetet në njohuri të përfituara nga studentët në ciklin paraardhës. Mësimi zhvillohet mbasdite duke i dhënë mundësi studenteve që të mos shkëputen nga puna. Çdo lëndë zhvillohet në bazë të syllabusit dhe planit mësimor të miratuar.

Me fillimin e semestrit syllabuset u vihen në dispozicion studentëve. Në këtë mënyrë, studentët njihen me temat të cilat do të zhvillohen gjatë semestrit, mënyrën e organizimit të orëve mësimore sikurse me format e kontrollit dhe mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjithashtu syllabuset i informojnë studentët mbi literaturën bazë të lëndës dhe atë plotësuese.

Nisur nga plani mësimor, format e mësimdhënies të përdorura nga UMSH në programin e studimit MP në SIB janë: leksionet, seminarët, labororet/ushtrimet, praktika profesionale dhe orët e konsultimit. Sasia e tyre përcaktohet në syllabusin e lëndës përkatëse. Pedagogët na përshkruan metodat dhe teknologjitë e përdorura në mësimdhënie, informacion i cili u konfirmua edhe nga takimi me studentët. Për realizimin e veprimtarive mësimore UMSH vë në dispozicion ambjente të përshtatshme për llojin e formën e mësimdhënies dhe të pajisura me mjetet e duhura didaktike. Mjetet didaktike janë tabela, kompjuteri, projektori. Gjatë leksioneve punohet me tabelën e bardhë dhe me projektor. Seminarët, për lëndët e profilit karakterizes të programit, zhvillohen në laborator ku studenti ka një kompjuter në dispozicion. Në këtë mënyrë studentët kanë mundësi të aplikojnë njohuritë teorike duke i aftësuar ata në aspektin praktik. Studentët nxiten që të jenë sa më interaktive gjatë leksion/seminareve dhe synohet trajtimi i situatave konkrete nga përvoja e profileve përkatëse dhe sjellja e shembujve nga bizneset shqiptare.

Vlerësimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren dhe mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi i studentit përbëhet nga disa komponentë: pjesëmarrja në auditor, tema/detyra e kursit, provimet e pjesshme dhe provimi përfundimtar. Pësia specifike e secilit prej tyre në vlerësimin përfundimtar është pjesë e syllabusit të lëndës. Në orët e seminareve pedagogët bëjnë vlerësimin e përgjithshëm dhe individual të dijeve të studentëve dhe kjo formë vlerësimi ndikon në vlerësimin përfundimtar të studentëve dhe çfarë është më e rëndësishme ndihmon pedagogun të kuptojë se ku qëndrojnë vështirësitë më të mëdha për studentët dhe me cilat çështje duhet punuar më mirë. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100 të cilat konvertohen në nota (4-10). Çdo rezultat nuk formalizohet pa i dhënë kohë studentëve për ankimim sipas përcaktimeve në

rregulloren e programit të studimit.

Në rregulloren e brendshme të UMSH parashikohet që sekretaria mësimore ruan evidenca për zhvillimin e orëve të mësimit me anë të evidencave në regjistrat përkatës dhe raporton në mënyrë periodike tek linja vertikale hierarkike për orët e pazhvilluara. Për rritjen e cilësisë së mësimdhënies përdoren instrumentat e vlerësimit nga studentët, nga departamenti, në bashkëpunim me njësinë e specializuar të sigurimit të cilësisë, dhe nga vlerësues të jashtëm të UMSH, sipas rastit.

Gjatë dy viteve të fundit në nivel institucioni organizohet aktiviteti studentor “Panairi i Ideve”, ku prezantohen punime të studentëve, të drejtuar nga pedagogë të lëndëve, të cilët në disa raste i kanë përfshirë ata në punën e tyre kërkimore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela nr. 14 e plotësuar në Aneks):

- Leksione
- Seminare / Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë profesionale

Nisur nga plani mësimor (Tabela nr. 10 në Aneks), një nga format e mësimdhënies të përdorura nga UMSH në programin e studimit MP në SIB është laborator. Zhvillimi i laboratorëve u konfirmua edhe gjatë takimeve me pedagogët dhe studentët. Në tabelën nr. 14 të plotësuar nga GVB, nuk janë përcaktuar orët mësimore që zhvillohen në laborator. Tabela Nr. 14 u plotësua nga RVJ bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 10: Planet mësimore të licensuara.

Format e kontrollit të njohurive (Tabela nr. 15 e plotësuar në Aneks)

Sipas Tabelës nr. 15 në Aneks por edhe pas shqyrtimit të syllabuseve, vëme re se shpërndarja e formave të kontrollit është e tillë që studenti 40% të vlerësimit e merr gjatë vitit dhe 60% në fund nëpërmjet provimit përfundimtar. 40% i vlerësimit gjatë vitit ndahet në 10% frekuentim dhe aktivizim dhe 30% plotësim i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) apo provime të ndërmjetme.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela nr. 16 e plotësuar në Aneks)

Nga takimi i organizuar me pedagogët dhe studentët na u konfirmua fakti që studentët shpesh herë përfshihen në punën kërkimore të pedagogëve. Në tabelën nr. 16 të plotësuar nga GVB, nuk është përcaktuar numri i studentëve të përfshirë në kërkimet shkencor individuale të pedagogëve.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi i studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” është miratuar në vitin akademik 2016-2017 por vetëm në vitin akademik 2017-2018 u arrit të rregjistrohen 15 studentë.

Procedurat e pranimit të studentëve të rinj për të ndjekur këtë program studimi bazohen në legjislacionin në fuqi të përcaktuar nga MAS, në Statutin e UMSH dhe në rregulloren e programit të studimit.

Të interesuarit mund të gjejnë informacionin e nevojshëm për kriteret, procedurën e aplikimit si dhe permbajtjen e programit të studimit:

- në faqen zyrtare të UMSH,
- duke ndjekur fushatat mediatike si reklamat televizive dhe ato në median e shkruar, daljet e pedagogëve në emisione televizive, apo edhe përdorimi i rrjeteve sociale.
- duke vizituar ambientet e UMSH ku studentët e ardhshëm potencial informohen jo vetëm nga përfaqesuesit e zyrës së informacionit dhe mbështetjes së studentëve por edhe nga pedagogët e fushës.

Studentët e rregjistruar në vitin e parë të këtij program studimi kanë një notë mesatare hyrje 6. Nuk ka statistika lidhur me numrin e të diplomuarve dhe cilësinë në dalje pasi studentët e parë diplomohen këtë vit. Nga vëzhgimet e kryera pranë sekretarisë mësimore u vu re që studentët kanë ruajtur po atë nivel mesatar hyrje në vlerësimet e provimeve të semestrit të parë.

Kohëzgjatja e programit të studimit të ciklit të dytë mbështetet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përfundim të të cilave lëshohen diploma “Master Profesional”. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që përshkruan programin, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Pranë UMSH gjendet zyra e këshillimit të studentëve dhe karrierës e cila ka në fokus të punës së saj jo vetëm këshillimin e studentëve përgjatë periudhës së studimeve por mban kontakte të rregullta me studentët e diplomuar (Alumni) për të mbledhur informacion në lidhje me punësimin e tyre pas diplomimit dhe përpunon statistikën për çdo program studimi. Për programin e studimit MP në SIB nuk ka ende statistika të tilla.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve të rinj në programin e studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” janë bazuar në kriteret bazë të vendosura nga MAS dhe kriteret e veçanta të vendosura nga vetë UMSH.

Kandidatëve që duan të ndjekin këtë program studimi, iu ofrohet dokumentacioni si më poshtë: rregullorja, plani mësimor, kriteret për pranimin në programin e ciklit të dytë Master, personeli akademik, kohëzgjatja dhe udhëzuesi mbi përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës, kontrata (tip).

Nëse kandidati kërkon të ndjekë studimet në këtë program studimi duhet të dorëzojë pranë Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, për konkurim, dosjen me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomën e përfutur në ciklin e parë të studimeve
- Listën e notave, fotokopje e noterizuar
- Fotokopje e noterizuar e ID
- Kërkesën për ndjekjen e studimeve në programin “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”.

Departamenti, në bashkëpunim me Koordinatorin e Studimeve Master ngrenë Komisionin e Vlerësimit. Ky i fundit, pas shqyrtimit të dosjeve i paraqet për miratim Dekanin të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, listën e studentëve fitues. Për kandidatët me debite formimi, përcaktohet mënyra e plotësimit të tyre dhe u ofrohen të gjitha lehtësitë e mundshme për këtë qëllim.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Programi i studimit MP në SIB nuk ka diplomuar ende studentët e parë, kështu që nuk mund të japim vlerësim për cilësinë e studentëve në dalje. Nota mesatare e studentëve në hyrje është 6.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela nr. 17 e plotësuar në Aneks)

Të dhënat në tabelën Nr. 17 në Aneks janë të dhënat për vitin akademik 2017-2018.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sipas legjislacionit në fuqi, studentët kanë të drejtë të transferojnë studimet e tyre nëpërmjet sistemit të krediteve (ECTS). UMSH pranon transferime të studentëve nga universitete të tjera dhe lejon transferimin e studentëve të tij në universitete të tjera në zbatim të legjislacionit në fuqi duke zbatuar procedurën e miratuar nga zyra juridike e saj. Nga vëzhgimet e kryera pranë sekretarisë mësimore, rezultoi se nuk ka asnjë rast transferimi studentesh në programin e studimit MP në SIB.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Disa nga studentët që ndjekin programin e studimit MP në SIB janë në mardhënie pune por në profile jo të lidhur me programin e studimit dhe kanë qenë të punësuar përpara se të fillonin studimet.

Numri total të diplomuarve

Nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën/jo në përputhje me diplomën)

Nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programin e studimeve "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që ndjekin programin e studimit MP në SIB janë rregjistruar në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimet në ciklin e dytë bëhen në përputhje me specifikat e programit, nevojat e tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukturore të institucionit. Kriteret e pranimit të kandidatëve për këtë program studimi janë përcaktuar nga njësia bazë ofruese e programit.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Studentët të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor (nga universitetet shqiptare (publike dhe jopublike) dhe nga vendet e tjera shqipfolëse) në fushën e Ekonomisë, Informatikës, Inxhinierisë dhe fushave të tjera të ndërlidhura me
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave"	

<p>dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriteve të pranimit.</p>	<p>to, si edhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS në studimet e ciklit paraardhës.</p> <p>Studentët dorëzojnë dokumentacionin e plotë, njihen me të drejtat e detyrimit dhe nënshkruajnë kontratën. UMSH i jep studentit numrin e tij të matrikullimit të përcaktuar nga MAS, i cili është unikal. Në sekretari u kontrollua dosja e regjistrimit për studentët e vitit 2017-2018 dhe u vu re që 4 studentë nuk janë pajisur akoma me nr. matrikullimi. Arsyet kryesore janë mosdorëzimi i diplomës origjinale të studimeve bachelor dhe mosregjistrimi nga një universitet apo shkollë e lartë tjetër. Nga sekretaria raportohet që kërkesa dhe dokumentacioni përkatës i është dërguar MAS si dhe po punohet për informimin e këtyre studentëve që të plotësojnë dokumentacionin dhe të kryejnë veprimet e nevojshme për rregjistrimin nga institucioni tjetër.</p>
	<p>UMSH mund të rishikojë politikat e pranimit të studentëve, në programin e studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” bazuar në performancën e studentëve dhe rezultatet që programi i studimit do të ketë në përfundim të vitit të parë të zhvillimit të tij (2017-2018).</p> <p>Kriteri 4 nuk aplikohet.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>UMSH ka ngritur zyrën e këshillimit të studentëve dhe karrierës. Cdo Fakultet ka përfaqësuesin e tij në këtë zyrë. Megjithëse ende nuk është finalizuar rregullorja për funksionimin e zyrës, fokusi kryesor i saj është informimi, nxitja dhe orientimi i studentëve universitar drejt tregut të punës dhe sipërmarrjes. Po shikohet mundësia që ZKSK të shkrihet në një zyrë të vetme me zyrën e PR dhe Marketing.</p> <p>Gjithashtu, ZKSK nëpërmjet tutorëve të studentëve identifikon dhe vendos në qendër të vëmendjes studentët duke i nxitur dhe orientuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vazhdimin e studimeve universitare në drejtimet master të UMSH. • për vazhdimin e studime të mëtejshme jashtë shtetit duke shfrytëzuar hapësirat që ofron EURAXESS, ERASMUS dhe institucione të tjera. • për pjesëmarrje në projekte studimore që mund të hartohen ose të zbatohen pranë UMSH. • për pjesëmarrje në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare. <p>Gjithashtu, gjatë takimit me studentët ata konfirmuan që informohen në mënyrë të detajuar për</p>

	akreditimin e institucionit dhe të programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, jo vetëm nëpërmjet takimeve me përfaqësuesit e ZKSK, por edhe me anën e formave të disponueshme elektronike, hard copy, broshura etj.
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Viti akademik, 2017-2018 është viti parë që mbyllet sikli “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” dhe diplomohet brezi i parë i studentëve.
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Nga vizita në zyrën e sekretarisë u konfirmua mbajtja elektronikisht dhe në mënyrë shkresore i të dhënave statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në hyrje, lëvizjet në vitet e ndërmjetme dhe në dalje për të gjitha programet e studimit.
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Sekretaria mësimore nëpërmjet portalit ofron në mënyrë elektronike dhe shkresore përgjigje të dokumentuar për rezultatet e secilit student të nivelit Master Profesional.
	Gjithashtu, Departamenti mban evidenca për secilën lëndë jo vetëm për të evidentuar rezultatet e arritura, kalueshmërinë, ecurinë e punës, por të nxirren përgjegjësitë konkrete për individët dhe njësitë, si edhe lihen detyrat për punën korente dhe në vazhdim.
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash të studentëve të diplomuar me qëllim ndjekjen e procesit të integritimit të tyre në tregun e punës. Gjithashtu pranë UMSH është krijuar Shoqata Alumni e cila organizon aktivitete të përvitshme me anëtarët e saj.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Përgjegjësinë për krijimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të studentëve që në pranimin e tyre deri në diplomim e ka sekretaria mësimore. Aktet rregullatore të UMSH përcaktojnë mënyrën e realizimit të kësaj detyre.
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Studentët, gjatë takimit me ta, na konfirmuan se informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi programin e studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, titullarët e lëndëve dhe organizimin e tij në 2 semestra ose 1 vit akademik.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Sistemi online (portali i studentit) i jep mundësinë studentëve të informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit (pikët e provimit
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	

	ndërmjetëm, detyrave kursit, aktivizimit në seminare). Sistemi u jep gjithashtu mundësi studenteve të vazhdojnë me procedurat e rishikimit të tezës, kolegiumit apo detyrave. Titullari i modulit u shpjegon studenteve arsyet e vlerësimit dhe ben ndryshimet perkatese nese e gjykon te arsyeshme. Me të përfunduar gjithë procesi, vlerësimi kalon në statusin “përfundimtar” dhe i kalon sekretarisë për t’u arkivuar edhe në trajtë procesverbali.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, pasi dëgjon preferencat e studentëve mbi praktikën, mundëson realizimin e kërkesave me institucione publike dhe private të cilat janë lidhur kohë më parë në kuadrin institucional.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH rregjistron studentët në programin e studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” sipas legjislacionit në fuqi. 2. UMSH angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar në lidhje me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit. 3. UMSH ka ngritur një bazë të dhënash nëpërmjet së cilës gjeneron statistika në lidhje me numrin e studentëve që djekin programet e studimeve si dhe statistika për punësimin e studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të këtyre programeve. <p><u>Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.</u></p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikën e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

UMSH është institucion i arsimit të lartë i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Së fundmi UMSH ka aplikuar për ofrimin e ciklit të tretë të studimeve.

Institucioni nxit dhe inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik për të qenë aktiv në veprimtarinë kërkimore. Sipas mundësive dhe buxhetit, UMSH e ka në politikën e vet të financojë kërkimet shkencore të personelit akademik. Gjithashtu UMSH ka unifikuar edhe procedurën e përcaktimit të literaturës që do të përfshihet në procesin mësimor.

Politikat e kërkimit shkencor në programin “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes” janë të njëjta me politikën institucionale të UMSH në këtë drejtim:

- Rritja e aftësive individuale dhe punës në grup të pedagogëve.

- Rritja e nivelit shkencor dhe cilësisë së mësimdhënies.
- Rritja dhe forcimi i punës shkencore të studentëve.
- Rritja e lidhjeve ndërkombëtare të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me universitete të tjera mbrënda dhe jashtë vendit duke u fokusuar në programe bashkëpunimi me financime të huaja, në projekte bashkëpunimi për studime të tregut shqiptar dhe për shkëmbim eksperience shkencore në shumë tematike mësimore.

Personeli akademik i UMSH, përfshirë edhe pedagogët e atashuar pranë programit të studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, në fillim të cdo viti shkollor, në bashkëpunim me departamentin, hartojnë programe vjetore të punës shkencore. Pjesë e këtyre programeve janë botimet shkencore, aplikimi në projekte të ndryshme, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, organizimi i aktiviteteve nga vetë departamenti si dhe lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor kryhet individualisht ose në grup pedagogësh që kanë specialitete të ngjashme ose korrelative. Gjithashtu, studentët përfshihen në kërkimin shkencor duke u atashuar pranë këtyre grupeve të pedagogëve, duke harmonizuar dëshirat e studentëve me specialitetet e pedagogëve. Temat e diplomave por edhe pjesëmarrja e studenteve si bashkëautore në konferenca të ndryshme shkencore janë rezultat i këtyre bashkëpunimeve. Pjesa më e madhe e studimeve lidhen me probleme dhe ndryshime të tregut shqiptar si për shëmbull tendencat e përhapjes së sistemeve të informacionit në bizneset vendase.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna e plotësuara në tabelën nr. 18 në Aneks janë në nivel institucional.

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Puna kërkimore shkencore e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, parashikohet në fillim të cdo viti shkollor, në bashkëpunim me departamentin, si pjesë e ngarkesës së tij vjetore. Realizimi i këtij programi, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore, është bazë vlerësimi e punës së tij.</p> <p>Pjesa më e madhe e studimeve lidhen me probleme dhe ndryshime të tregut shqiptar. Një pjesë tyre që lidhen me</p>

	programin e studimit, shpesh përfshihen me tema të veçanta në leksione ose në detyra kursi.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi i studimit nuk ofron lëndë apo specialitet në gjuhë të huaj por përdor gjërësisht literaturë në gjuhë të huaj, më së shumti si literaturë ndihmëse.</p> <p>Disa nga pedagogët që japin mësim në këtë program kanë mbaruar studimet dhe disa të tjerë janë specializuar në universitete të huaja. Në lëndë të caktuara, për tema të caktuara, janë ftuar manaxherë të huaj të kompanive shqiptare për leksione të veçanta.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UMSH nxit dhe mbështet kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor, sidomos të pedagogëve të rinj. Mbështetja ofrohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> – duke i lehtësuar nga ngarkesa mësimore kur ata kanë përmbushur me sukses të gjitha detyrimet doktrale në vitet paraardhëse dhe janë në vitin e fundit të doktoraturës. – duke ofruar mbështetje financiare si financim i plotë ose i pjesshëm për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit, realizimin e botimeve në revista me faktorë impakti apo trajnime për formate të veçanta, me objektiva të veçanta. <p>Në departamentin përgjegjës për programin MP SIB aktualisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> – një PAE është në përfundim të doktoraturës në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës. – një PAE ka filluar në janar të 2017 studimet doktrale në Francë dhe – një tjetër PAE ka nënshkruar kontratën fillon studimet doktrale në Gjermani në 01.06. 2018.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Qendrës Kërkimore Shkencore mbledh dhe analizon të gjitha të dhënat që lidhen me botimet brenda e jashtë, studimet shkencore si dhe projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MP SIB.</p> <p>Të dhënat në formën e treguesve sasiorë merren në departament pasi vlerësohet planifikimi i punës shkencore ashtu edhe realizimi i saj i pasqyruar në orë në formularin individual të punës mësimore dhe shkencore. Gjithashtu po në departament janë</p>

	<p>depozituar kopje të punimeve shkencore.</p> <p>Një kopje e të gjitha materialet të punës shkencore por edhe ato mësimore që lidhen me të gjenden edhe në bibliotekë për përdorim nga studentët.</p> <p>Institucioni ka struktura që monitorjnë dhe evidentojnë projektet në nivel kombëtar dhe nderkombëtar në të cilat merr pjesë personeli i institucionit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik, i atashuar pranë programit të studimeve MP SIB, angazhohet në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit. 2. UMSH nxit dhe mbështet kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. 3. UMSH disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij. 4. Aktualisht, UMSH nuk ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj por ka një personel akademik të kualifikuar për ta përmbushur këtë objektiv në të ardhmen. <p><u>Duke u mbështetur tek argumentat e paraqitura standardet e mësipërme plotësohen.</u></p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UMSH ka ndërtuar raporte bashkëpunimi në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto raporte janë zyrtarizuar nëpërmjet nënshkrimit të kontratave, ku janë specifikuar fushat e bashkëpunimit dhe detyrimet e palëve. (*dokument lista e kontratave të bashkëpunimit*).

Objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë të natyrave të ndryshme si psh:

- shkëmbimi i informacioneve shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore të përbashkëta,
- njohja reciproke dhe unifikimi i lëndëve të caktuara,
- lehtësimi i lëvizjes së pedagogëve dhe studentëve,
- marrja e ekspertizave për probleme të vecanta nga institucionet shtetërore,
- realizimi i praktikave mësimore,
- përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në studimet e tregut të kompanive private

Duke qenë se viti 2017-2018 është viti i parë i hapjes së programit të studimit “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, marrëveshjet të cilat lidhen me këtë program studimi janë:

- me subjektet private dhe shtetërore për ofrimin e praktikave mësimore për studentët të cilët nuk janë në mardhënie pune në profilin ku ata studiojnë, ose nuk kanë mundësi të gjejnë një kompani ku kryejnë praktikën mësimore. Disa prej Institucioneve ku studentët po kryejnë praktikat janë: Infosoft, Ikub, Abissnet dhe Banka e Shqipërisë.

- me universitete dhe institucione te huaja dhe vendase për organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta
- me universitetet vendase për levizjen e pedagogëve si UT apo UBT

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Të dhënat e plotësuara në tabelën nr. 19 në Aneks janë në nivel institucional.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
